



Vërejtje: Ky document është i vlefshëm vetëm nëse është përgatitur dhe nënshkruar në gjuhën maqedonase. Përkthimi i autorizuar në gjuhën shqipe shërben për ta kuptuar më mirë atë.

KUSHTET ER PËRGJITHSHME TË KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE PËR PËRDORIMIN E SMS BANKINGUT

1. Dispozitat e përgjithshme

1.1. Me Kushtet e përgjithshme të përdorimit të shërbimit SMS bankingu (në tekstin e mëposhtëm: Kushtet e përgjithshme), rregullohen të gjitha llojet e shërbimeve, mënyra dhe kushtet e përdorimit të Shërbimit SMS të Komercijalna banka AD Skopje (në tekstin e mëposhtëm: Banka) dhe përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësit për përdorimin e shërbimit SMS bankingu (në tekstin e mëposhtëm: shërbimi SMS).

1.2. Shërbimi SMS është shërbimi i formimit i Bankës, i cili mund të ofrohet përdoruesve të kartave pagesore të lëshuara nga Banka të marrin lajmërimi SMS në telefonin e tyre celular, të definuar në pikën 4, të Kushteve të përgjithshme.

2. Përdoruesit e SMS bankingu

Përdoruesi i SMS bankingu mund të bëhet secili klient-person fizik, i cili:

- është përdoruesi i kartës së debitit dhe/ose kartës së kreditit,
- ka të hapur llogari rrjedhëse të transaksionit,
- ka dorëzuar Kërkesë për përdorimin e Shërbimit SMS dhe i pranon Kushtet e përgjithshme për përdorimin e shërbimit SMS bankingu,
- posedon telefon celular të rrjetit të operatorëve të autorizuar në territorin e Republikës së Maqedonisë.

3. Kontraktimi i shërbimit

3.1. Banka do të mundësojë Përdoruesit të shërbimit, shfrytëzimin e të gjitha shërbimeve që ofrohen nëpërmjet shërbimit SMS, kurse Përdoruesi i shërbimit në mënyrë të pavarur, sipas zgjedhjes së tij i përcakton shërbimet të cilat dëshiron t'i shfrytëzojë. Me mundësimin e disa prej shërbimeve, përdoruesi pajtohet t'i pranojë edhe të gjitha njoftimet tjera pa pagesë, për të cilat Banka nuk paguan kompensim.

3.2. Përdoruesi i shërbimit SMS mund të bëhet secili klient i bankës, i cili do të plotësojë dhe nënshkruajë Kërkesë për shfrytëzimin e shërbimit SMS për persona fizikë.

3.3. Me nënshkrimin e Kërkesës, pranimin e Kushteve të përgjithshme, si dhe miratimin e Kërkesës nga ana e Bankës, krijohen marrëdhënie kontraktuese ndërmjet Bankës dhe Përdoruesit të shërbimit.

3.4. Përdoruesi i shërbimit me nënshkrimin e tij, në Kërkesë vërteton se është i njoftuar me Kushtet e përgjithshme dhe pa kundërshtim e pranon aplikimin e të njëjtave në këtë marrëdhënie kontraktuese.

3.5. Banka e mban të drejtën e diskrecionit ta refuzojë Kërkesën për shfrytëzimin e shërbimit SMS.

4. Karakteristikat e shërbimit SMS

4.1. Shërbimi SMS bankingu është shërbim informues i Bankës, i cili i mundëson Përdoruesit nëpërmjet sms-ve në telefonin e tij celular, të lajmëruar në Bankë, marrjen e informatave për gjendjen dhe ndryshimet, përkatësisht për secilin transaksion të realizuar nëpërmjet kartës pagesore nga ana e Bankës.

4.2. Njoftimet SMS përmbajnë informacione, të cilat janë në përputhje me Kërkesën e plotësuar nga ana e Përdoruesit të shërbimit, për të gjitha shumat mbi 500 denarë, ose më shumë për caktuar nga ana e Përdoruesit të shërbimit, si dhe informacione të tjera të lidhura me shumën:

- kontrollin e gjendjes, tërheqjen e parave të gatshme nga bankomati, transaksione në POS терминаlet, shumën e transaksionit, vendin e transaksionit, ndryshimet në llogaritë e kartave (njoftime për pagesa), të ndodhura në vend dhe jashtë.

4.3. Përdoruesi i shërbimit SMS me plotësimin e fushës së posaçme në Kërkesë, ka mundësi të zgjedhë t'i marrë SMS njoftimet për momentin (menjëherë pas ndodhjes së ndryshimit), ose në periudhë të caktuar kohore gjatë ditës (paraprakisht të definuara nga ana e Bankës).

5. Kompensim për shërbimin SMS

5.1. Përdoruesi pajtohet që Banka të paguajë kompensim për shfrytëzimin e shërbimit SMS në përputhje me Vendimin për tarifimin e kompensimeve të shërbimeve, të cilat kryen Komercijalna Banka AD Skopje.

Kompensimi do të paguhet në fillim të secilit muaj me ngarkimin e llogarisë së transaksionit të përdoruesit të shërbimit, për SMS e dërguara në muajin paraprak.

Në rast se Përdoruesi i shërbimit nuk ka mjete të mjaftueshme në llogarinë e tij të transaksionit, pajtohet që banka, pa paralajmërim, për të realizuar pagesën e kompensimeve për SMS shërbimin t'i përdorë mjetet ekzistuese të Përdoruesit në Bankë, në të gjitha bazat ose rrjedhëse ose hyrje të ardhshme në denarë apo valutë në llogaritë e tij në Bankë.

6. Ndryshimi i të dhënave

Përdoruesi i shërbimit SMS është i detyruar që me shkrim ta njoftojë Bankën për:

- ndryshimin e numrit të telefonit celular,
- humbjen, apo vjedhjen e telefonit celular (menjëherë pas humbjes apo vjedhjes),
- për ndërprerjen e shërbimit SMS (me kërkesë), dhe
- riaktivizimin e numrit për dorëzimin e informatave.

Nëse Përdoruesi nuk silllet në përputhje me nenin 1 të kësaj pike, Banka nuk merr përgjegjësi për dëmin e ndodhur për shkak të dërgimit të SMS njoftimit.

7. Mbrojtja e të dhënave personale dhe fshehtësia e informacioneve

7.1. Të gjitha të dhënat, të cilat Përdoruesi i shërbimit do t'i dorëzojë në Bankë paraqesin fshehtësi afariste të Bankës dhe do të përdoren enkas për qëllime vetanake. Koha e dërgimit të porosisë paraqet kohën kur porosia e lëshon sistemin informativ të Bankës. Banka e garanton fshehtësinë dhe integritetin e të dhënave deri në momentin e daljes së tyre nga sistemi informativ

i Bankës. Banka nuk mban përgjegjësi nëse për shkak të problemeve teknike, ose për shkak të ndërprerjes së punës së operatorit celular ose së sistemit autorizues të Bankës ndodhë që porositë të mos dërgohen në kohë ose të mos dorëzohen aspak, nëse në Kërkesën për përdorimin e shërbimit SMS, përdoruesi ka shënuar numër jo të saktë, ose të huaj të telefonit celular, në të cilin duhet të arrijnë SMS njoftimet.

7.2. Banka obligohet t'i mbrojë të dhënat personale të përdoruesit të shërbimit, në përputhje me legjislacionin dhe aktet e brendshme të Bankës.

8. Anulimi i shërbimit SMS

Shfrytëzuesi mundet ta anulojë përdorimin e shërbimit SMS nëpërmjet plotësimit të fushave të posaçme në Kërkesën me shkrim për shfrytëzimin e shërbimit SMS.

9. Dispozitat përfundimtare

9.1. Me dorëzimin e Kërkesës së plotësuar dhe të nënshkruar për shfrytëzimin e shërbimit SMS të Komercijalna Banka AD Skopje dhe pranimin e të njëjtit nga Banka, konsiderohet se është lidhur marrëveshje për shfrytëzimin e shërbimit SMS, ndërmjet Bankës dhe Përdoruesit.

9.2. Në përputhje me politikën e saj afariste, Banka mund t'i ndryshojë kushtet e përdorimit të shërbimit SMS dhe me këtë rast është e obliguar ta njoftojë Përdoruesin me ndryshimet.

9.3. Përdoruesi pajtohet të njoftohet për ndryshimin e kushteve nëpërmjet raporteve të kartave pagesore, ose në mënyrë tjetër të informimit, të cilin Banka vet do ta caktojë. Nëse Përdoruesi nuk pajtohet me ndryshimin, mund të kërkojë ndërprerje të shfrytëzimit të shërbimit SMS në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të ndryshimit të kushteve. Me këtë rast, Përdoruesi është i detyruar që bankës t'i dorëzojë Kërkesë me shkrim për anulimin e shërbimit SMS. Në të kundërtën do të konsiderohet se përdoruesi pajtohet me ndryshimet.

9.4. Të gjitha kontestet e mundshme, banka do të përpiqet t'i zgjidhë në frymën e marrëdhënieve të mira afariste dhe nëse kjo nuk është e mundur kompetent do të jetë Gjykata në Shkup.

**KOMERCIJALNA BANKA
AD SKOPJE**

.....
Nënshkrimi i përdoruesit